



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	08.09	702	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shloja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
	6039/2023			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr. 999/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.999/2023, të datës 17.07.2023, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1; nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 08.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.999/2022, e datës 17.07.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet** Njoftimi i datës 12.07.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzor, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me përfundimin e procedurës së avancimit, me numër reference RN00010807 si dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 12.07.2023, ndërsa, mbesin në fuqi veprimet administrative të ndërmarra në procedurën paraprake dhe testin me shkrim.
- III. Obligohet** Komisioni i Vlerësimit për Ngritjen në Detyrë i themeluar me Vendimin Nr.Ref.02/72, të datës 14.03.2023, të Sekretar i Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të bëjë vlerësimin e jetëshkrimit si dhe vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë të ankuesit.
- IV. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi), më datë 17.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 16.08.2023, përmes shkresës më numër protokollit 998/2023, kundër veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionit për ngritje detyrë dhe vlerësim jo korrekt, lidhur me procesin e rekrutimit ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Drejtor i Departamentit të Tregtisë" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 03.08.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit bazuar në kërkesën e kryetarit të Kolegjit, e në mbështetje të dispozitave të nenit 17, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 5846/2023, të datës 29.08.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.99/2023, të datës 29.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5259/2023 të parashtruar nga ankuesi, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimi i ankesës me numër protokollit 5259/2023 të datës 17.07.2023 me datën 16.08.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 17.05.2023; E-maili i datës 12.07.2023- njoftimi lidhur me refuzimin e vlerësimit të biografisë për E-maili i datës 12.07.2023 ku janë publikuar rezultatet përfundimtare; E-maili i datës 12.07.2023 për refuzimin e ankesës të z.Visar Xani lidhur me fazën e vlerësimit të intervistës; rezultatet e vlerësimit të datës 20.03.2023; 30.03.2023; 16.05.2023 nga anëtari i komisionit Gani Seferi; rezultatet e vlerësimit të datës 20.03.2023; 20.03.2023; 16.05.2023; 16.05.2023 nga kryesuesja e Komisionit të vlerësimit Lebibe Haliti; rezultatet e vlerësimit të datës 20.03.2023; 30.03.2023; 16.05.2023 nga anëtarja e Komisionit të Vlerësimit Zade Kuqi; E-maili zyrtar i datës 11.08.2023 vlerësimet e komisionit për kandidatin Visar Xani; E-maili i datës 07.08.2023-kërkesë për veprim; E-maili i datës 07.08.2023; E-maili i datës 28.07.2023-Përgjigje nga MPB; E-maili i datës 27.07.2023-Përgjigje nga MPB; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit i datës 03.08.2023; E-maili i datës 10.07.2023 nga Kryesuesja e Komisionit të Vlerësimit për Menaxherin e Personelit; E-maili i datës 06.07.2023, nga Menaxherja e Personelit për Komisionin Vlerësues; E-maili i datës 05.07.2023 nga DMZP-ja për Menaxheren e Personelit në MINT; E-maili i datës 30.06.2023; Njoftimi i datës 12.07.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në MINT; E-maili i datës 12.07.2023 nga ankuesi për Menaxheren e Personelit; E-maili i datës 13.07.2023 nga Menaxherja e Personelit në MINT dhe Vendimi me numër protokollit 5846 i datës 29.08.2023 i Kryetarit të Këshillit për shtyrje të afatit për vendimmarrje; Ankesën me numër protokollit 3861/2023, të datës 27.04.2023, të parashtruar nga ankuesi V.X në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00010807 të shpallur nga MINT me datë 26.01.2023; Aplikacionin e kandidatit V.X të datës 16.02.2023, së bashku me përgaditjet profesionale, përvojën e punës dhe trajnimet; Njoftimin lidhur me rezultatin e testimit me shkrim të dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.X me datë 20.03.2023; Njoftimin lidhur me rezultatin e jetëshkrimit të dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.X me datë 20.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për V.R me datë 31.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për V.X me datë

13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për R.B, A.D, L.H, Z.K dhe G.F me datë 13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga R.B për A.D, L.H, Z.K dhe G.F me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për L.H, Z.K dhe G.S me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për A.D, V.R-V dhe B.B me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.R-V për V.X me datë 27.03.2023; Kërkesë për qasje në dokumente publike e dërguar me e-mail nga V.X për D.B, ZKP.MINT, B.B dhe V.R-V me datë 04.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për V.X me datë 22.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për A.D, V.R-K dhe B.B me datë 21.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.S me datë 20.03.2023; Kërkesë e dërguar me e-mail nga V.X për L.H, G.S dhe Z.K me datë 14.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga 13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për R.B, A.D, L.H, Z.K dhe G.S me datë 07.04.2023; Kërkesën për ndërmarrjen e veprimeve ligjore për përmbyllje të procesit rekrutues të parashtruar nga ankuesi V.X për Kryetaren e Komisionit të vlerësimit për ngritjen në detyrë me datë 14.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3999/2023 të datës 02.05.2023 të dërguar nga KPMSHCK për MINT; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 2576/2023 të datës 12.05.2023 të dërguar nga MINT për KPMSHCK; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe të nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X me datë 12.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe të nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X me datë 28.01.2022; Vërtetim me numër protokollit 87/2022 i datës 27.05.2022 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 16.02.2023 e lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00010807; Vendim me numër protokollit 1244/02 i datës 14.03.2023 i lëshuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Zarin me numër 2576/03 i datës 12.05.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje MINT), me datë 26.01.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin për Ngritje (avancim) në Detyrë, me numër reference RN00010807, për pozitën e punës "Drejtor i Departamentit të Tregtisë", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 10.02.2023 deri me 17.02.2023, ndërsa sipas listës së aplikantëve rezulton se numri i kandidateve aplikues ka qenë dy, me ç'rast procedura ka vazhduar vetëm me një kandidat në këtë rast ankuesin, si kandidat i vetëm që ka plotësuar kriteret e pozitës së shpallur.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit përkatësisht vlerësimit me shkrim (testit) si dhe intervistës me gojë të mbajtur me datë 30.03.2023, mirëpo, Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë (referuar në tekstin e mëtejme Komisioni i Vlerësimit) i themeluar me Vendimin Nr.Ref.02/72, të datës 14.03.2023, të Sekretar i Përgjithshëm të MINT-it, nuk kishte përfunduar procesin e vlerësimit dhe së ankuesi nuk ishte njoftuar me rezultatin e vlerësimit. Pasi që nuk ka pranuar ndonjë njoftim lidhur me rezultatet e vlerësimit, ankuesi me datë 27.04.2023 parashtron ankesë në Këshill për shkak të mos përmbylljes së procesit rekrutues, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.677/2023, të datës 26.06.2023, ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 27.04.2023, ka anuluar Vendimin me numër protokollit

3025/02, të datës 26.05.2023, të Komisionit të Vlerësimit si dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 16.05.2023, duke obliguar këtë të fundit që të bëjë rivlerësim të jetë shkrimit të ankuesit dhe të zhvillojë vlerësim të ri përmes intervistës me gojë.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e MINT-it, më datë 12.07.2023 ka nxjerrë njoftimin se procedura për Ngritje -Avancim në Detyrë për pozitën Drejtor i Departamentit të Tregëtisë, i publikuar me datë 26.01.2023, përfundon pa kandidat fitues edhe pas rivlerësimit nga ana e Komisionit Vlerësues në bazë të vendimit të Këshillit, kurse po në të njëjtën ditë ka njoftuar ankuesin se : *janë publikuar rezultate përfundimtarë të vlerësimit për shpalljen me numër reference RN00010807, në SIMBNJ. Kandidatet e pakënaqur ndaj rezultatit të vlerësimit konkurrimit kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë brenda 30 ditësh në KPSHCK, nga data e pranimit të këtij njoftimi...*

Ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshill, kundër veprimeve dhe mosveprimeve të Komisionit për ngritje në detyrë dhe vlerësim jo korrekt, lidhur me procesin e rekrutimit ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Drejtor i Departamentit të Tregëtisë" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë. Shton se bazuar në dokumentacionin e vlerësimit të siguruar sipas kërkesës për qasje në dokumente zyrtare është vërtetuar së Komisioni i Vlerësimit ka bërë ndryshime të vlerësimeve, përkatësisht, Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësim me datë 23.03.2023 dhe 30.03.2023 ku janë bërë ndryshime të pikëve të vlerësimeve lidhur me biografinë dhe vlerësimin e intervistës me gojë, andaj, kërkon që Këshilli të merr si të mirëqenë vlerësimin e datës 20.03.2023, sipas të cilit ankuesi ka arritur 60.66 pikë, si të mjaftueshme për tu shpallur kandidat fitues dhe në këtë mënyrë ankuesit ti njihet e drejta e fituar sipas ligjit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e ngritjes në detyrë përkatësisht nenit 39 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: 1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3. Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë. 4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, për procedurën e ngritjes në detyrë zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 deri 9 të nenit 34 të këtij ligji..."

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 52 ku parashihet se "1.Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë. 2.Ngritja në detyrë është procedurë konkurruese. Konkurimi organizohet për një pozitë të lirë. 3.Konkurimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil dhe neni 53 1.Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e parvojës në punë; 2.2. nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nënparagrafi

1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende; 2.3. nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mire" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë. 3.Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale "shumë mirë" apo shkëlqyeshëm për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët. 4.Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë.

Në kuptim të kuadrit ligjor si lartë si dhe duke marr parasysh pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji nga analizimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nuk ka zbatuar Vendimin e Këshillit A.nr.677/2023 të datës 23.06.2023, me të cilin ishte obliguar Komisioni i Vlerësimit, që në rishqyrtim të rivlerësonte jetëshkrimin e ankuesit pasi që sipas Këshillit ishte vërejtur nënvlerësim i jetëshkrimit dhe të zhvillonte vlerësim të ri përmes intervistës me gojë, duke u udhëzuar Komisionin e Vlerësimit që të mbante evidencë përkitazi me pyetjet e parashtruara dhe vlerësimin e ankuesit nga secili anëtar veç e veç. Mirëpo, bazuar në provat e përcjella nga organi i punësimit sipas përgjigjes në ankesën A.nr.999/2023, rezulton se me asnjë provë nuk argumentohet që Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar intervistë më shkrim në procedurë të rishqyrtimit dhe ka bërë rivlerësim të jetëshkrimit, rrejdhimisht, Komisioni i Vlerësimit në procedurë të rishqyrtimit i është shmangur ndërmarrjes se veprimeve administrative të propozuara nga Këshilli sipas Vendimit A. Nr.677/2023, ngase, sipas Rezultateve përfundimtare të datës 12.07.2023 kemi vlerësim të përsëritur përkatësisht të njëjtë sikurse me vlerësimin e datës 16.05.2023, ku ankuesi ka akumuluar gjithsej 57.33 pikë.

Gjegjësisht, lidhur me vlerësimin e ankuesit në ri procedurë ekziston vetëm shkresa me emërtimin "Renditja përfundimtare e kandidatëve ", e cila përmban një listë me pikët e përgjithshme të kandidatit-ankuesit, duke mos përfshirë të dhëna tjera sqaruese lidhur me pyetjet e parashtruara dhe vlerësimet e anëtarëve të Komisionit Vlerësues veç e veç për jetëshkrimin dhe intervistën me gojë, veprime këto në kundërshtim më nenin 48 ndërlidhur me nenin 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mblidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mblidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit.*

Në kontekst të pretendimit ankimor së Këshilli me rastin e vendosjes duhet të merr për bazë vlerësimin e parë të Komisionit të Vlerësimit të datës 20.03.2023, Kolegji ve në theks faktin së nga provat e lëndës konstatohet së Komisioni i Vlerësimit kishte bërë vlerësimin e ankuesit lidhur me jetëshkrimin dhe intervistën me gojë, mirëpo, Komisioni i Vlerësimit disa herë radhazi ka bërë ndërhyrje në vlerësimin e ankuesit, e që në vlerësimin e Kolegjit, veprimet e tilla janë të papranueshme ligjërisht, mirëpo, pretendimi ankimor për marrjen në konsideratë të vlerësimit të datës 20.03.2023, është i pamundshëm dhe i pazbatueshëm, pasi që Këshilli me Vendimin.nr.677/2023 të datës 26.06.2023 ka anuluar të gjitha veprimet administrative ndërlidhur me këtë fazë të vlerësimit.

Andaj, siç u përcaktua më lart, rrjedhimisht duke qenë se procedura e ngritjes në detyrë për pozitën e punës "Drejtore të Departamentit të Tregtisë", është përcjell me të meta ligjore të evidentuar si me lart, Kolegji i Këshillit vlerëson së pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejta dhe të bazuara,



rrjedhimisht, Kolegji vendosi që të anulohet Njoftimi i datës 12.07.2023, i Njesisë së Burimeve Njerëzor, të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me përfundimin e procedurës së avancimit, me numër reference RN00010807, për pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Tregtisë, si dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 12.07.2023, të mbesin në fuqi veprimet administrative të ndërmarra në procedurën paraprake dhe testin me shkrim, kurse obligohet Komisioni i Vlerësimit që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të bej vlerësimin e jetëshkrimit si dhe vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë të ankuesit.

Në kuptim të zbatimit të vendimeve të Këshillit, Kolegji rikujton përcaktimin ligjor se në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personat përgjegjës të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimet dhe rrethanat si me sipër, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.999/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

